



Prishtinë: 20.12.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1089_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1874_10_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **21.11.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 20.12.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Z. B. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit: 006432 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1874_10_18** i datës 12.10.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 21.11.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Z. B., i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se në përgjigjet e NQ "Termokos" ndaj ankesave të tij për të janë të njohura dhe se ato përgjigje janë të paargumentuara dhe janë përgjigje pa u bërë verifikimi i gjendjes faktike, pasi që nuk ka ardhur asnjë komision për të verifikuar gjendjen faktike, përderisa në përgjigje theksohet se janë bërë disa zbritje paushalle. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se disa vija të përmendura edhe sot nuk punojnë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se nga data 17.01.2015 i pranon të gjitha faturat dhe ato i paguan rregullisht. Konsumatori ka theksuar se NQ "Termokos" nuk ka qenë i interesuar të bëjë verifikimin e ngrohjes në banesat e tij.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se përgjigjet e NQ Termokos kanë qenë të njohur për konsumatorin dhe kanë qenë të paargumentuara, Bordi i ZRRE ka vërejtur se në përgjigjet me shkrim të NQ "Termokos" në ankesat e parashtruara nga konsumatori, është theksuar se NQ "Termokos" parashtruara ka pranuar se ka bërë zbritjet në faturim, dhe atë si në vijm: i) Përgjigja



nr.490 e datës 06.03.2012 zbritje në faturim 20% për periudhën janar 2006 – shkurt 2011; ii) Përgjigja nr.1136 e datës 27.03.2015 zbritje e sipërfaqes së faturuar për 9.00 m² nga dhjetori 2014 e tutje.

Sa i përket pikës së kundërshtimit lidhur me mosfunksionimin e vijave të ngrohjes në banjo dhe korridor, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se NQ "Termokos" pas konstatimit të punëtorëve të autorizuar të NQ "Termokos" se në banesën me shifër 006433 nuk punon vertikalja (vija) e ngrohjes në korridor me sipërfaqe prej 9.00 m², nga dhjetori 2014 e tutje nuk e ka faturuar konsumatorin me këtë sipërfaqe.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizave të bëra transaksioneve të konsumatorit të shifrës 006432 ku janë të paraqitura shumat e faturave të energjisë termike, vërehet se N.Q. "Termokos" ka bërë zbritje konsumatorit në faturim për shkak të cilësisë së dobët të ngrohjes, dhe kjo evidentohet në faturat e ngrohjes dhe në transaksionet e konsumatorit.

Bordi i ZRRE thekson se në përgjigjen e NQ "Termokos" përgjigjen nr.441 të datës 02.02.2017 theksohet se ekipi i NQ "Termokos" ka dalur në vendin e ngjarjes pas daljes në vend ka konstatuar ngrohjen cilësore, me një qarkullim më të dobët të ujit në nivel rajoni, por që kjo pasqyrohet në zbritjet në fatura e të pasqyruara edhe në transaksionet e konsumatorit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit Z. B.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së